



Prilazja / Dokumenti / Document / Documento	28.04.2022	2	viti / god / year
Prilazja / Dokumenti / Document / Documento	2499/2022	113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.233/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli-Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 15.03.2022 me numër A.nr.233/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensum material*” kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.233/2022 e datës 15.03.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e *nië shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil* për ankuesin
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi sipas ndryshim dhe plotësim të aktit të emërimit me numër të protokollit 2046 të datës 11.06.2019 është i sistemuar në vendin e punës “Zyrtar për Informim Publik, Qendra Koordinuese e Deminimit” në Ministrinë e Mbrojtjes, Grada A-2, i cili me datë 20.01.2022 me numër të protokollit 88/4 parashtron kërkesën për realizimin e pagës jubilarë tek Departamenti i Politikave të Personelit dhe Rekrutimit.

Drejtori i Departamentit për Politikat e Personelit dhe Rekrutimit me datë 04.02.2022 me numër të protokollit 174 i kthen përgjigje ankuesit lidhur me kërkesën e tij të datës 20.01.2022.

Ankuesi me datë 14.03.2022 parashtron ankesë kundër përgjigjes së datës 20.01.2022 në Komisionin e Ankesave të Ministrisë së Mbrojtjes, ankuesi me datë 14.03.2022 njoftohet nga njësia e personelit për përdorimin e mjeteve juridike. Ankuesi pas pranimit të e-mail-it të datës 14.03.2022 me datë 15.03.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 1350/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për realizimin e pagës jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.03.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes. Më datë 30.03.2022 organi i punësimit ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë faqe 1/19.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 15.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 11.06.2019; Kërkesa për realizimin e pagës jubilarë e datës 20.01.2022; Përgjigja në kërkesë e datës 04.02.2022; e-mail-at e datave 04.02.2022, 14.03.2022; Prova shtesë e ankuesit e datës 16.03.2022; Kontrata e marrëdhënies së punës me numër 2245; Akt emërimi i ankuesit; Rregullorja (QRK) Nr.02/2020 për Pagat, Shtesat Mbi Pagë dhe Kompensimet Tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë; Vendimi i datës 28.07.2021 me Nr.10/21 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e **bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas kontratës së marrëdhënies së punës me numër të kontratës 01/2011 me datë 01.02.2011 ka themeluar marrëdhënie pune me Ministrinë e Forcës së Mbrojtjes në vendin e punës *"Zyrtar për Informim Publik"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit të parashtruar me ankesën e datës 15.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka kërkuar që ti njihet e drejta e kompensimit të pagës jubilarë pasi që ka dhjetë (10) vjet pune të pandërprerë në shërbimin civil konkretisht në Ministrinë e Mbrojtjes, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar pasi që me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 që është përcaktuar se nëpunësit civil gëzojnë të drejtën e kompensimit material me rastin e arritjes së dhjetë (10) vjetë pune të pandërprerë në organin e punësimit: *"2.Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.3. „shpërblimi i përvjetorit (jubile)“*, si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 33/2010 për Shtesat në Pagë dhe





Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil përkatësisht me nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ku është përcaktuar që: „Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune“, konkretisht ne baze të kontratës së marrëdhënies së punës me numër 01/2011 të datë 01.02.2011,“ andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se në bazë të dispozitave të lartpërmendura ankuesit i takon kompensimit i një shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil sepse ne baze të kontratës së marrëdhënies së punës me numër 01/2011 të datës 01.02.2011 ka bere dhjetë (10) vjetë pune të pandërprerë ne Ministrinë e Mbrojtjes në vendin e punës “Zyrtar për Informim Publik”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbrojtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbrojtës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A.nr.233/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Udhëheqësës së Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

